

**VENDIM**  
**Nr. 906, datë 11.12.2019**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHË TË OBJEKTIT  
NDËRTESE, ME SIPËRFAQE 400 m<sup>2</sup>, PJESË E PRONËS ME EMËRTIMIN  
“KLUBI I GJUE TISË”, ME VENDNDODHJE NË LEZHË, NË PËRDORIM TË  
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERTARE, PËR NJË NDRYSHIM NË  
VENDIMIN NR. 1058, DATË 16.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, DHE  
PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 414, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja “ç”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Lezhë të objektit ndërtesë, me sipërfaqe 400 m<sup>2</sup>, pjesë e pronës me emërtimin “Klubi i Gjuetisë”, me vendndodhje në Lezhë, në përdorim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ta përdorur me qëllim nxitjen e turizmit dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Bashkinë Lezhë.

2. Prona, e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit që i bashkëlidhet vendimit nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”.

3. Prona, e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi i shtohet listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lezhë, miratuar me vendimin nr. 414, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave.

4. Bashkisë Lezhë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Bashkia Lezhë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare që, në momentin e dorëzimit të pronës, të hartojnë dokumentacionin hartografik ku të pasqyrohet sipërfaqja e pronës, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

6. Ngarkohen ministri i Brendshëm, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, kryetari i Bashkisë Lezhë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

# FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE  
( Per invenatrizimin e pronave te veçanta )

41

| Bashkia / Shengjin |                                           |                 |                      | Identifikoi: M. Ngjeliu inxh ndertimi<br>( emri,mbiemri, pozicioni zyrtar )<br>Supervizoi : Aranit Xhekaj, Dr. Auditit<br>( emri,mbiemri, pozicioni zyrtar )<br>Fusha e perdorimit te prones: Rezidence<br>Aprovoi: Drejtore Elsa Meksi<br>(emri, Mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma vulav) |                                   |                                           |                                             |                                                      |                                                                   |                                                                                                                                                                          |
|--------------------|-------------------------------------------|-----------------|----------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|-------------------------------------------|---------------------------------------------|------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Nr.<br>Rend        | A                                         |                 |                      | B                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                                   |                                           | C                                           |                                                      |                                                                   |                                                                                                                                                                          |
|                    | Zona<br>Kadastr. &<br>Indeksi i<br>Hartes | Nr.<br>Pasurise | Lloji<br>i<br>Prones | Emri i<br>Adresa                                                                                                                                                                                                                                                                               | Sip.<br>Totale e<br>prones<br>m/2 | Nga sip.<br>Totale:<br>Sa ndertese<br>m/2 | Funksioni per te<br>cilin<br>perdoret prona | Institucioni/Enti<br>me pergjegesi<br>administrative | Institucioni/Enti<br>perdorues<br>Statusi juridik i<br>perdorimit | Te dhena te<br>tjera                                                                                                                                                     |
| 41                 |                                           |                 | Truall<br>Ndertese   | Godina Klubi<br>i Gjuetise Lezhe                                                                                                                                                                                                                                                               | 24000                             | 400                                       |                                             | K.Ministrave                                         | D SH Q                                                            | Objekti qe<br>nuk eshte<br>VKM Nr.12<br>07.01.1999<br>por eshte<br>ne inv. Fizik<br>dhe eshte<br>ne gjendjen<br>kontabel te<br>D SH Q-se<br>shfrytezuat<br>nga te tjeret |
|                    |                                           |                 |                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                                   |                                           |                                             |                                                      |                                                                   |                                                                                                                                                                          |
|                    |                                           |                 |                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                                   |                                           |                                             |                                                      |                                                                   |                                                                                                                                                                          |

43